



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
REKTORI

Nr. 169 / Prot.

33

Tiranë, më 19.02.2019

UDHËZIM

Nr. 2, datë 19.02.2019

PËR

DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.1, DATË 29.01.2019 "PËR PROCEDURAT E PRANIMIT DHE REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E SPECIALIZIMEVE AFATGJATA NË FUSHËN E MJEKËSISË, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË, PËR VITIN AKADEMIK 2018-2019"

Në mbështetje të neneve 18, 70, 71, 77 dhe 89 të ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të Vendimit nr. 3, datë 28.01.2019 të Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë "Për miratimin e shpërndarjes së kuotave të pranimit dhe tarifave të shkollimit në programet e ciklit të tretë të studimeve, specializime afatgjata në fushën e mjekësisë, për vitin akademik 2018-2019, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë", dhe VKM-së nr.1013, datë 10.12.2010 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP)", i ndryshuar me VKM nr. 371, datë 26.04.2017, sot Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA),

UDHËZOJ:

Në Udhëzimin nr 1, datë 29.01.2019 "Për procedurat e pranimit dhe regjistrimit në programet e specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2018-2019" bëhen këto ndryshime:

1. Pika 6 bëhet si më poshtë:

Dekanatet brenda datës **28.02.2019** shpallin në faqen zyrtare ueb të fakulteteve dhe/ose UMT- së listën emërore të kandidateve të regjistruar për konkurrim, të cilët plotësojnë kriteret për të marrë pjesë në procesin e konkurrimit. Kandidatët brenda 2 ditëve nga shpallja verifikojnë listën emërore dhe, në rast pasaktësish, bëjnë kërkesë për saktësim pranë dekanatit të fakultetit përkatës brenda datës **02.03.2019**.

Dekanatet pas kryerjes së verifikimeve shpallin brenda datës **04.03.2019** listën përfundimtare të kandidatëve, si dhe kalendarin e zhvillimit të intervistave me gojë dhe testimit të informatizuar. Datat e zhvillimit të testimit të informatizuar konsultohen me QSHA lidhur me disponibilitetin për zhvillimin e testimit të informatizuar. Listat e studentëve të ndara sipas datave përkatëse të zhvillimit të intervistës me gojë dhe në vijim të testimit të informatizuar përcaktohen me short. Listat përfundimtare dhe kalendarin e zhvillimit të testimit të informatizuar i dërgohen QSHA dhe MASR brenda kësaj date sipas

formatit të kërkuar nga QSHA. Kandidatët duhet të kryejnë intervistën me gojë dhe më pas testimin e informatizuar.

2. Pika 8 bëhet si më poshtë:

Konkurrimi fillon më datën **05.03.2019** me intervistën me gojë. Rezultatet e intervistës me gojë shpallen nga Komisioni pas aprovimit nga Dekanët. Dekanët shpallin rezultatet përfundimtare të intervistës me gojë në faqen ueb të fakulteteve përkatëse dhe UMT-së, si dhe në ambientet e fakulteteve dhe rektoratit brenda 2 ditëve pune nga përfundimi i intervistës me gojë.

3. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë, bëhet publik në faqen zyrtare të institucionit, si dhe ngarkohen njësitë kryesore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, për zbatimin e këtij Udhëzimi.

REKTORI

Arben GJATA

